



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 02 Mars 2021

Nr: 108

VENDIM

**PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT “ALEANCA”,
(AL) PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, pika 2, neni 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neni 2 të Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga përfaqësuesit e subjektit zgjedhor “Aleanca”, për regjistrimin e koalicionit zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

VËREJ

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Në mbështetje të nenit 65 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës të 25 Prill 2021, pranë KQZ partitë politike si më poshtë vijon:

1. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, me Kryetar z. Eduart Abazi, miratuar me vendimin nr. 30, datë 05.02.2021;
2. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, me Kryetar z. Gaqo Apostoli, miratuar me vendimin nr.50, datë 11.02.2021;
3. Partia e Reformave Demokratike e Shqipërisë, me Kryetar z. Krenar Rryçi, miratuar me vendimin nr. 36, datë 05.02.2021;



4. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, me Kryetar z. Valentino Mustaka, miratuar me vendimin nr. 65, datë 15.02.2021;
5. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, me Kryetar z. Genci Sakaj, miratuar me vendimin nr. 67, datë 15.02.2021;
6. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, me Kryetar z. Ymer Kurti, miratuar me vendimin nr.90, datë 22.02.2021;
7. Partia Qytetare Shqiptare, me Kryetar z. Joan Velko, miratuar me vendimin nr. 87, datë 22.02.2021.

Me shkresën nr. 1481 prot., datë 24.02.2021, në Zyrën e Protokollit të KQZ-së, partitë e sipërpërmendura, nëpërmjet kërkesës së bërë nga partia përfaqësuese Aleanca Demokratike Shqiptare kërkojnë regjistrimin e koalicionit “Aleanca” (AL) si subjekt zgjedhor për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Aleanca”, (AL) është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni.

Marrëveshja përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “ALEANCA”;
3. Shkronjat nistore të koalicionit “AL”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Autorizimin e z. Eduart Abazi kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare të dorëzojë listat shumemërore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit
6. Autorizimin e z. Besnik Spahiu dhe z. Dritan Mullahaj, të cilët do të kenë të drejtën të përfaqësojnë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;

Në marrëveshje është përcaktuar instrumenti i propozimit dhe renditjes së kandidatëve të listave shumemërore për çdo parti anëtare e koalicionit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bëri verifikimet përkatëse dhe konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga 7 (shtatë) partitë e sipërcituara është në përputhje me nenin 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 65 e 66, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neni 2, të Udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

VENDOS

1. Të regjistroj Koalicionin “Aleanca”, (AL) si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:
 - a. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare;
 - b. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet;
 - c. Partia e Reformave Demokratike e Shqipërisë;
 - ç. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane;
 - d. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare;
 - dh. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve;
 - e. Partia Qytetare Shqiptare.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

